



**Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly**

LEGJISLATURA IV

Sesioni pranveror

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Mbledhja nr.82

Prishtinë, më 06. 12. 2013 në ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL

i mbledhjes së Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Në mbledhje morën pjesë: Jasmina Zhivkobiq, Elmi Reçica, Albert Kinolli, Lumnije Morina, Glauk Konjufca, Vesna Mikiq, Jelena Bontic, Rasim Demiri dhe Mursel Halili.

Munguan: Petar Miletqi, Mufera Sinik, Glauk Konjufca

Stafi mbështetës i komisionit, koordinatori i Komisionit.

Mbledhjen e kryesoi: Jasmina Zhivkoviq, kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-233 për Buxhetin e Kosovës për vitin 2014;**

Kryesuesi - konstatoi se janë përmbushur kushtet procedurale për fillimin e mbledhjes, dhe hapi mbledhjen me këtë pikë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryesuesi – konstatoi se rendi i ditës u miratua, pa ndryshime.

2. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-233 për Buxhetin e Kosovës;

Kryesuesja – sqaroi Projektligjin nr. 04/L-233 për Buxhetin e Kosovës për vitin 2014. Duke pasur parasysh, para se gjithash, esencën e zgjidhjes së propozuar me nenin 9 të Projektit të Buxhetit, i cili ka të bëjë me Fondin për përkrahjen e mediave të minoriteteve, mediat multietnike dhe mediat e grupeve të tjera. Kryesuesja tha se deri në përfundimin e vitit 2011. financimi ka qenë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit. Ajo pastaj tha se mënyra e financimit të transmetuesit publik më nuk ekziston dhe se paragrafi 11 i nenit 20 të Ligjit për RTK nuk është funksional, është i papërdorshëm. Me qëllim të aplikimit të nenin 9 të Këtij Ligji janë bërë konsultime me Zyrën e Kryeministrit. Është

arritur pajtimi se grandet e ndara nuk ndikojnë në pavarësinë e tyre. Deri në fund të vitit 2011. nga parapagimi në Fondin e RTK- së janë tubuar 375.902 euro.

Deri më tani Fondi i ka ndarë 43 grande për Fondin për përkrahjen e mediave të minoriteteve, mediat multietnike dhe mediat për grupet e tjera të posaçme.

Struktura e ndarjes së grandeve për media në të gjitha konkursat është:

- 18 grande janë ndarë për mediat serbe
- 7 për mediat në gj. Boshnjake
- 7 për 5 grupe multietnike
- 5 grande për 3 media në gj. Turke
- 4 për 3 media të grupeve të tjera
- 2 grande për 1 medium në gj. Rome

Në vazhdim ajo në formë amendamenti propozoi formulimin e nenit 9.2

“Pesë përqind (5%) nga shuma e përgjithshme e mjeteve të ndara për RTK -në nga Buxheti i Kosovës do të transferohen në Fond për përkrahjen e mediave të bashkësive minoritare, mediave multietnike dhe grupeve të tjera të posaçme. Kjo do të funksionoj në kuadër të Zyrës së Kryeministrit”.

Lumnije Morina u pajtua me amendamentin e propozuar nga kryetarja e Komisionit, dhe për propozimin për ndryshimin e nenit 9.2 të Projektligjit, me kusht që marrëveshja për riformulim të jetë arritur me Zyrën e Kryeministrit dhe që këto grande të mos ndikojnë në pavarësinë e tij.

Elmi Reçica tha se, nëse pas shqyrtimit, Komisioni funksional për buxhet dhe financa e përkrah riformulimin e kësaj dispozite, ai nuk ka asgjë kundër që Komisioni ta miratoj këtë amendament. Komisioni me shumicë votash dhe një abstenim nxori këtë:

P ë r f u n d i m

Miratohet amendamenti i propozuar në nenin 9 paragrafi 2, me tekst si vijon:

“Pesë përqind (5%) nga shuma e përgjithshme e mjeteve të ndara për RTK -në nga Buxheti i Kosovës do të transferohen në Fondin për përkrahjen e mediave të bashkësive minoritare, mediave multietnike dhe grupeve të tjera të posaçme. Kjo do të funksionoj në kuadër të Zyrës së Kryeministrit”. Amendamenti i propozuar do t’i dërgohet Komisionit për shqyrtim.

3. Të ndryshme

Glauk Konjufca pyeti kryetaren pse Komisioni po e vonon shqyrtimin e Projektligjit për statusin dhe drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve të luftës, pjesëtarëve të UÇK-së, dëshmorëve dhe familjeve të tyre? Si rezultat i kësaj ky Projektligj nuk mund të procedohet në Seancë Plenare. Për atë arsye Komisioni duhet sa më shpejtë të ndërmarr aktivitete adekuate dhe të dalë me raport të vetë.

Kryetarja e përkrahi propozimin, dhe tha se ky Projektligj do të jetë në rend të ditës në javën e ardhshme, dhe se shkak i vonësës ka qenë procesi zgjedhor dhe fushata parazgjedhore.

Mbledhja përfundoi në orën 11:45

Përgatitur nga:
Departamenti i Komisioneve parlamentare

Kryetarja e Komisionit

Jasmina Živković